

Vendim nr. 168 datë 17.07.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

| | |
|-------------------|-----------|
| Fiona Papajorgji, | Kryesuese |
| Sandër Beci, | Anëtar |
| Illir Toska, | Anëtar |

në datën 17.07.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 9 (E) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ERMIR SKEJA**, përfaqësuar nga avokat Indrit Sefa, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 992, datë 16.04.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2023-1733, datë 31.10.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 49, pika 3, shkronja “e”, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 07.05.2015, në aksin rrugor Burrel-Milot, në vendin e quajtur “Baz” të rrethit Mat, janë plagosur me armë zjarri shtetasit L.P. dhe V.T., ndërsa dëmtimet e tyre janë kategorizuar si të rënda, pasi kanë qenë të rrezikshme për jetën në çastin e shkaktimit. Për këtë ngjarje, në përfundim të hetimeve paraprake, organi i akuzës ka dërguar për gjyq çështjen penale në ngarkim të kërkuesit Ermir Skeja, i akuzuar për kryerjen e veprave penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, të mbetur në tentativë dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuara nga nenet 79, shkronja “dh” dhe 22, si dhe 278, paragrafi i parë, të Kodit Penal (*KP*).

2. Me vendimin nr. 35, datë 14.06.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka vendosur ndryshimin e kualifikimit ligjor të veprës penale nga “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, të mbetur në tentativë, në veprën penale “Vrasja e kryer në kushtet e tronditjes së fortë psikike”, të mbetur në tentativë, dy herë, në dëm të shtetasve L.P. dhe V.T., të parashikuar nga nenet 82 e 22 të *KP*-së, duke deklaruar fajtor dhe dënuar kërkuesin dy herë me 4 vjet burgim për këtë vepër penale. Po kështu, gjykata e ka deklaruar fajtor dhe dënuar kërkuesin me 3 vjet burgim edhe për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve luftarake”, të parashikuar nga neni 278, paragrafi i parë, i *KP*-së. Në bashkim të dënimeve, në aplikim të nenit 55 të *KP*-së, kërkuesi është dënuar përfundimisht me 7 vjet burgim. Gjykata ka arritur në përfundimin se nuk provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri (kërkuesi) ka dashur të vrasë shtetasit L.P. dhe V.T., mbartur nga dashja tipike si formë fajësie në kuadrin subjektiv të kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 79 i *KP*-së, ndërsa provohet se dashja në rastin konkret është e ndikuar nga tronditja e fortë psikike, shkaktuar autorit nga dhuna fizike dhe psikologjike e të dëmtuarve. Ajo është shprehur se përmbushen cilësitë e elementit ligjor të tronditjes së fortë psikike sipas nenit 82 të *KP*-së, pasi ka rezultuar e provuar se tronditja psikike e të pandehurit ka qenë e fortë, e tillë që ka errësuar në shkallë të tillë vetëdijen dhe aftësinë e tij për të kontrolluar veprimet e veta, fakt që provohet nga

plagët e mëdha që i janë shkaktuar atij nga dhuna fizike e shtetasit L.P., e gërshetuar me dhunën psikologjike të shkaktuar nga të dy të dëmtuarit, L.P. dhe V.T. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim prokurori dhe kërkuesi.

3. Me vendimin nr. 992, datë 16.04.2018, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke e deklaruar fajtor kërkuesin për veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, të mbetur në tentativë, të parashikuar nga nenet 79, shkronja “dh” e 22 të KP-së dhe dënuar atë me 15 vjet burgim, si dhe për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, të parashikuar nga neni 278, paragrafi i parë, i KP-së dhe dënuar atë me 3 vjet burgim. Në bashkim të dënimeve, gjykata e apelit e ka dënuar kërkuesin përfundimisht me 16 vjet burgim. Gjykata e apelit e ka gjetur të drejtë ankimin e prokurorit, duke vlerësuar se gjykata e shkallës së parë kishte gabuar në çmuarjen e provave dhe për rrjedhojë dhe në zbatimin e ligjit penal për sa i përkiste kualifikimit ligjor të veprës penale në dëm të shtetasve L.P. dhe V.T. Në analizë të provave dhe mekanizmi i ngjarjes, gjykata e apelit ka arritur në përfundimin se elementi i dhunës në drejtim të të pandehurit nuk provohet të ketë qenë në atë nivel sa t’i shkaktonte atij tronditje të fortë psikike. Sipas asaj gjykate, nuk provohet që ndaj të pandehurit të ketë pasur fyerje të rënda dhe as veprime të rënda dhune nga ana e të dëmtuarit L.P., të tilla që në moment (e çastit) të shkaktonin tronditje të fortë psikike tek i pandehuri, duke e bërë atë të veprojë në kushtet e vetëdijes së errësuar dhe nën ndikimin e këtij afekti, prandaj ai, me veprimet e tij të kundërligjshme, ka konsumuar elementet e veprës penale, të parashikuar nga nenet 79, shkronja “dh” e 22 të KP-së. Kundër vendimit ka paraqitur rekurs kërkuesi, duke kërkuar prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe kthimin e akteve për rishqyrtim.

4. Me vendimin nr. 00-2023-1733, datë 31.10.2023, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi pretendimet e ngritura në të nuk bënin pjesë në ato të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe se ato kishin të bënin me çështje të faktit dhe analizë e interpretim të gabuar të provave në funksion të kualifikimit juridik të faktit penal. Sipas Kolegjit Penal, gjykata e apelit, brenda domenit ekskluziv të saj, ka argumentuar në mënyrë të plotë dhe shteruese qëndrimin e saj në lidhje me çmuarjen e provave për aspekte konkrete të faktit penal, duke mos i dhënë kështu shkas një ndërhyrjeje nga Gjykata e Lartë në lidhje me zbatimin e ligjit procedural penal. Ai kolegji ka arsyetuar se, referuar

faktit penal, gjykata e apelit me të drejtë ka arritur në përfundimin për praninë e elementeve të veprës penale të parashikuar nga neni 79, shkronja “dh”, i KP-së, për të cilën i pandehuri është vënë nën akuzë, duke marrë në vlerësim anën objektive të veprës penale, nga e cila arrihet të lexohet edhe ana subjektive e saj për qëndrimin psikik të të pandehurit në momentin e kryerjes së veprës penale, vlerësim ky që e ka çuar atë gjykatë në konkluzionin se veprimet e të pandehurit kanë pasur si qëllim vrasjen e të dëmtuarve, gjë e cila nuk është realizuar për shkaqe të pavarura prej tij.

5. Në datën 13.05.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 24.05.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se gjatë procesit gjyqësor të kundërshtuar nuk është respektuar e drejta për proces të rregullt në drejtim të:

- 6.1. *Parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit (reformatio in peius)*, pasi gjykata e apelit e ka shqyrtuar çështjen në mënyrë të njëanshme, duke marrë në konsideratë vetëm shkaqet e ankimit të prokurorit, pavarësisht se edhe kërkuesi (i pandehuri) kishte paraqitur ankim. Gjykata e apelit nuk e ka shqyrtuar çështjen brenda shkaqeve të ankimit të kërkuesit, në kundërshtim me nenin 425 të KPP-së.
- 6.2. *Parimit të prezumimit të pafajësisë dhe standardit të arsyetimit*, pasi gjykata e apelit ka zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin material penal, duke i konsideruar rrethanat e faktit në mënyrë të gabuar dhe të padrejtë. Ajo ka konsideruar të vërtetë faktin se kërkuesi ka kërcënuar të dëmtuarin L.P., por kjo nuk mbështetet në provat e dosjes dhe nuk ka asnjë provë që mbështet deklaratimet e dëshmitares N.C. Nuk ka asnjë provë në lidhje me përfundimet e gjykatës së apelit, madje është provuar e kundërta, se shtetasi L.P. ka ushtruar dhunë ndaj kërkuesit. Gjykata nuk i ka bërë analizë dhe kualifikim të drejtë veprës penale, por ka analizuar elementet duke u nisur nga këndvështrimi që u ka dhënë ngjarjeve dhe veprimeve, si dhe duke mos i shqyrtuar provat në harmoni me njëra-tjetrën. Ajo nuk ka analizuar dhe nuk ka konkluduar në

lidhje me raportin shkak-pasojë për sa u takon veprimeve të kërkuesit, ndërkohë që shkak i vërtetë, i drejtpërdrejtë, i atëçastshëm që ka sjellë përdorimin e armës dhe ardhjen e pasojës ishte dhuna intensive e ushtruar nga shtetasi L.P. dhe V.T. ndaj kërkuesit, e cila ka krijuar në mënyrë befasuese të shpejtë të menjëhershme dëmtime në shëndetin e tij, rrezikimin e jetës së tij ose perceptimin se jeta e tij ishte në rrezik. Gjykata e apelit nuk ka marrë në konsideratë deklaratimet e dëshmitarëve, çka provon se shtetasi L.P. ka shkuar për t'u konfliktuar me kërkuesin dhe për t'i zënë pritë.

- 6.3. Veprimet e kërkuesit janë kryer në kushtet e mbrojtjes së nevojshme dhe kishin për qëllim mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të tij, duke mënjanuar rrezikun që i kanosej jetës dhe shëndetit. Vepra penale për shtetasin L.P. duhej të cilësohej si plagosje e rëndë me dashje që ka qenë e rrezikshme për jetën në çastin e shkakimit të saj, sipas nenit 88/1 të KP-së.
- 6.4. Gjykata e apelit ka vepruar në kundërshtim me vendimin nr. 212, datë 16.07.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që në një rast analog e ka cilësuar veprën penale të kryer nga i pandehuri si plagosje e rëndë me dashje, sipas nenit 88/1 të KP-së. Ajo nuk ka trajtuar as çështjen e tentativës dhe nuk është shprehur për këtë edhe pse është ndër shkaqet e ankimit të paraqitur nga kërkuesi dhe as për ekzistencën e elementeve, siç janë qëllimi i autorit të veprës penale, pra nëse dëshironte ardhjen e vdekjes së të dëmtuarve apo jo.
- 6.5. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi nuk është pranuar kërkesa e kërkuesit për analizimin e drejtë të dëshmive dhe fakteve të çështjes. Gjykata e apelit është bazuar në një interpretim të gabuar të fakteve dhe rrethanave për ta deklaruar kërkuesin fajtor dhe ka interpretuar në mënyrë të gabuar prova të tjera thelbësore dhe bindëse të kërkuara prej tij.
- 6.6. Edhe pse pretendimet e kërkuesit janë ngritur në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë ajo nuk i ka marrë në shqyrtim ato dhe nuk ia ka nënshtruar shqyrtimit gjyqësor, por ka vendosur mospranimin e rekursit. Gjykata e Lartë nuk e ka pranuar rekursin për rrethana procedurale duke u treguar e njëanshme, pasi nuk është shprehur në vendim në lidhje me çështjen e tentativës dhe dallimin mes plagosjes së rëndë dhe vrasjes me dashje, megjithëse janë ndër shkaqet e ankimit të kërkuesit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuarit

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kritere paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues.

8. Kolegji vlerëson se kërkuari legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

9. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kërkuari i është drejtuar Gjykatës pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik efektiv në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

10. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Gjykata ka theksuar se vënia në

dispozicion të palëve e vendimeve të gjykatës ua bën të njohura atyre arsyet e vendimmarrjes, duke u dhënë mundësinë të ankohen nëse e shohin të arsyeshme. Për rrjedhojë, si datë e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, që i korrespondon momentit të konstatimit të cenimit, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, është data e marrjes dijene efektivisht për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijene konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Kolegji vëren se vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 31.10.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 13.05.2024. Për qëllime të këtij shqyrtimi i është kërkuar informacion Gjykatës së Lartë në lidhje me momentin në të cilin ky vendim është bërë i disponueshëm për palët. Me informacionin e datës 20.06.2024, Gjykata e Lartë ka sqaruar se vendimi i saj nr. 00-2023-1733, datë 31.10.2023 është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 12.01.2024. Po kështu, kërkuesi ka paraqitur, bashkëlidhur kërkesës, edhe shkresën nr. 3233/1 prot., datë 20.06.2024 të Drejtorisë së Administrimit Gjyqësor të Gjykatës së Lartë, sipas së cilës, vendimi i asaj gjykate i është komunikuar avokatit të kërkuetit në datën 15.01.2024. Për rrjedhojë, duke konsideruar këtë të fundit si datën nga e cila vendimi është bërë i disponueshëm për palët, konsiderohet se kërkesa është paraqitur brenda afatit 4-mujor.

12. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, rezulton se kërkuesi ka pretenduar *cenimin e parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit (reformatio in peius)*, pasi, sipas tij, gjykata e apelit ka marrë në konsideratë vetëm shkaqet e ankimit të prokurorit, pavarësisht se edhe kërkuesi (i pandehuri) ka bërë ankim, duke mos e shqyrtuar çështjen dhe duke mos u shprehur për pretendimet e tij, në kundërshtim me nenin 425 të KPP-së.

13. Parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit (*reformatio in peius*) parashikohet në legjislacionin procedural penal dhe konkretisht në nenin 425, pika 3, të KPP-së, sipas të cilit: “*Kur apelu është vetëm i pandehuri, gjykata nuk mund të caktojë një dënim më të rëndë ... dhe as t’i japë faktit një cilësim juridik më të rëndë.*”. Ky parim është i lidhur me garancinë e aksesit në

gjykatë si element i procesit të rregullt dhe zbatimi i tij është një garanci më shumë për të gjykuarin, me qëllim që ai të realizojë në mënyrë efektive të drejtën për t'iu drejtuar me ankim gjykatës. Gjykata është shprehur se ekzistenca e këtij parimi u jep mundësi të gjykuarve që të mos heqin dorë nga garancitë që ofron Kushtetuta vetëm nga frika se mund të dëmtohen rëndë interesat e tyre. Nga ky këndvështrim, mosrespektimi i parimit për mosrëndimin e pozitës së të pandehurit do të përbënte njëkohësisht cenim të thelbit të një gjykimi dhe në veçanti të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së (*shih vendimin nr.15, datë 22.07.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Kolegji vëren se, në çështjen konkrete, gjykata e apelit është vënë në lëvizje mbi bazën e ankimit të prokurorisë dhe të të pandehurit (kërkuesit). Ndërsa nga ana e prokurorisë është kërkuar ndryshimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke u deklaruar kërkuesi fajtor për veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, të mbetur në tentativë, të parashikuar nga nenet 79/dh e 22 të KP-së dhe rritjen e masës së dënimit për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve luftarake”, të parashikuar nga neni 278 i KP-së, në ankimin e kërkuesit është kërkuar ndryshimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe deklarimi i tij i pafajshëm për veprën penale në dëm të shtetasit L.P., pasi është kryer në kushtet e mbrojtjes së nevojshme, ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga “Vrasja e kryer në kushtet e tronditjes së fortë psikike”, të mbetur në tentativë, në “Plagosja e rëndë nga pakujdesia”, të parashikuar nga neni 91 i KP-së, si dhe aplikimin e nenit 59 të po këtij kodi.

15. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se në kushtet që gjykata e apelit e ka shqyrtuar çështjen edhe mbi bazën e ankimit të prokurorit, që ka kërkuar ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë në drejtim të cilësimit juridik të veprës penale, për rrjedhojë, edhe të masës së dënimit, pretendimi për mosrespektimin e nenit 425, pika 3, të KPP-së është haptazi i pabazuar, për sa kohë që ajo gjykatë nuk është vënë në lëvizje vetëm mbi bazën e ankimit të kërkuesit.

16. Kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë dhe standardit të arsyetimit, si dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, duke i lidhur këto pretendime me mënyrën e gabuar dhe të padrejtë të vlerësimit të provave dhe rrethanave të faktit nga gjykata e apelit. Sipas tij, nga provat e administruara nuk janë provuar faktet e pranuar nga gjykata dhe gjykata e apelit nuk i ka bërë analizë dhe kualifikim të drejtë veprës penale, pasi nuk ka analizuar dhe nuk ka konkluduar në lidhje me raportin shkak-pasojë, për sa u takon

veprimeve të kërkuesit, të cilat janë kryer në kushtet e mbrojtjes së nevojshme dhe kishin për qëllim mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të tij. Sipas kërkuesit, gjykata e apelit nuk ka respektuar as praktikën e Kolegjit Penal në një çështje analoge dhe është bazuar në një interpretim të gabuar të fakteve dhe rrethanave, duke interpretuar në mënyrë të gabuar prova të tjera thelbësore dhe bindëse të kërkuara prej tij. Sipas tij, edhe pse këto pretendime janë ngritur në rekurs, Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje për sa kohë ka vendosur mospranimin e tij.

17. Sipas parimit të prezumimit të pafajësisë, të garantuar në nenin 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe ai kërkon që deklarimi i fajësisë së të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimin nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka theksuar se ajo mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për mënyrat e marrjes së provave, por jo për mënyrën e vlerësimit të tyre (*shih vendimet nr. 37, datë 19.09.2011; nr. 45, datë 10.10.2010; nr. 23, datë 17.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe se ato mund të merren në konsideratë vetëm nëse përmes këtij procesi cenohen të drejta kushtetuese themelore, duke bërë vlerësim të natyrës kushtetuese të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022; nr.7, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në kuptim të këtyre standardeve, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuesit, si më sipër, janë me natyrë thellësisht ligjore dhe kanë të bëjnë më çështje të vlerësimit të provave dhe zbatimit të ligjit, të cilat, si rregull, janë atribut i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe nuk mund të bëhen objekt i kontrollit kushtetues. Duke qenë se kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë se si vendimet gjyqësore të kundërshtuara kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt, konsiderohet se ai nuk ka arritur ta ngrëjë këtë pretendim në nivel kushtetues. Po në këtë drejtim, Kolegji vlerëson edhe se thjesht fakti se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, nuk është në vetvete i mjaftueshëm, në aspektin kushtetues për të vënë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt nga ajo gjykatë.

19. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.